

D O R A C A K¹

PËR GJYKIM NË DISTANCË NË PROCEDURË CIVILE

Janar, 2021

¹ Autori mban të drejtën që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin të këtij manuali, varësisht nga ndryshimet dhe plotësimet të Ligjit për Procedurë Kontestimore.

DORACAK PËR GJYKIM NË DISTANCË NË PROCEDURË CIVILE

Për parandalimin e transmetimit të KOVID-19, shumica e shqyrtimeve në procedurë civile duhet që të mbahen përmes të ashtuquajturit **gjykim në distancë** (“*Remote trial*”). Kjo mund të bëhet nëpërmjet telefonit ose nëpërmjet video lidhjes. Edhe pas përfundimit të pandemisë nga KOVID-19, nëse jo të gjithë, atëherë shumica e gjykimeve në procedurë civile duhet të vazhdojnë të mbahen në këtë mënyrë.



Ky dokument sqaron se çfarë është gjykimi në distancë dhe si vazhdon kronologjia e gjykimit. Kjo konsiston në gjykimet në procedurë civile, d.m.th. në procedurë kontestimore dhe jashtëkontestimore. Nuk konsiston në llojet e tjera të procedurave.

Ky dokument jep përgjigje në pyetjet në vijim:

1. Çfarë është gjykimi në distancë?
2. Çfarë është gjykimi hibrid?
3. Për cilat lloje të procedurave civile konsiston gjykimi në distancë?
4. Çfarë kuptimi kanë shprehjet vijuese?
5. Si të vishem për gjykimin në distancë?
6. Çfarë do të ndodhë në gjykimin në distancë?
7. Si të kyçem në gjykimin në distancë?
8. A ka shpenzime kyçja në gjykimin në distancë?
9. Cilat pajisje, aplikacione ose softver më duhen?
10. Çfarë nëse jam i shqetësuar se nuk mund ta punoj teknologjinë?
11. A mund të kem dikë pranë gjatë kohës së gjykimit në distancë?
12. Çfarë nëse duhet të bisedoj privatisht me përfaqësuesin tim ose shoqëruesin gjatë gjykimit?
13. Çfarë nëse dëshiroj ballë për ballë – gjykim “normal”?
14. Çfarë nëse diçka shkon keq?
15. Çfarë ndodh pas gjykimit në distancë?
16. Ku mund ta gjej këtë doracak?

1. Çfarë është gjykimi në distancë?

Gjykimi në distancë është ai gjykim që mbahet në mënyrë që palët e përfshira, dëshmitarët, ekspertët, personat e tretë, pjesëmarrësit, shoqëruesit e pjesëmarrësve, përfaqësuesit e përkohshëm, të autorizuarit në procedurë **(në tekstin e mëtutjeshëm: personat e involvuar në procedurë)**, nuk duhet të vijnë personalisht në gjykatë, respektivisht në ndërtesën e gjykatës. Në vend të kësaj, ata lidhen në gjykim nëpërmjet telefonit ose nëpërmjet video lidhjes duke përdorur telefonin ose ndonjë pajisje tjetër (laptop ose tablet).



Ndonjëherë, për shkaqe të arsyetuara dhe/ose objektive, edhe gjykatësi do të jetë në shtëpi dhe jo në gjykatë respektivisht në ndërtesën e gjykatës.

Përveç faktit se personat e involvuar në procedurë nuk janë në ndërtesën e njëjtë, gjykimi në distancë është njësoj si edhe gjykimet ku të njëjtit vijnë në gjykatë personalisht, dhe procesi është krejtësisht i njëjtë. Gjykata i ka të gjitha autorizimet dhe pritet që palët e involvuara në procedurë këtë ta trajtojnë po aq seriozisht si edhe gjykimin “normal”.

2. Çfarë është gjykimi hibrid?

Gjykimi hibrid është përzierje e gjykimin në distancë dhe gjykimin “normal”. Kjo domethënë se disa nga personat e involvuar në procedurë personalisht marrin pjesë në gjykatë, respektivisht në ndërtesën e gjykatës, ndërsa disa prej tyre i bashkangjiten shqyrtimit nga distanca nëpërmjet telefonit ose video lidhjes. Gjykimi hibrid mund të ndodhë nëse një person nuk mund të paraqitet fizikisht në gjykatë ose nëse salla e gjykimin nuk është mjaftueshëm e madhe që të gjithë të mund të akomodohen dhe të mbajnë distancë të sigurtë sociale.



Kjo mund të ndodhë në disa konteste kur ka më shumë persona të involvuar në procedurë. Në disa raste, njëra palë mund të merr pjesë në sallën e gjykatës (ose në ndërtesë tjetër) dhe mund të jetë në të njëjtën hapësirë me përfaqësuesin e tij, por

megjithatë mund të përfshihet në gjykim përmes video lidhjes. Ekzistojnë shumë kombinime të ndryshme në varësi nga lloji i rastit dhe rrethanat e veçanta.

3. Për cilat lloje të procedurave civile konsiston gjykimi në distancë?

Gjykimi në distancë do të zbatohet në procedurat në bazë të të cilave gjykata shqyrton dhe vendos në kontestet për të drejtat dhe detyrimet themelore të njeriut dhe qytetarit, për marrëdhëniet personale dhe familjare të qytetarëve siç janë kontestet e punës, tregtare, pronësore dhe kontestet e tjera civilo-juridike, nëse me Ligjin për Procedurë Kontestimore për disa nga këto konteste nuk është përcaktuar, për ato vendos gjykata sipas rregullave të ndonjë procedure tjetër (**në tekstin e mëtutjeshëm: procedura kontestimore**), dhe në procedurat sipas të cilave gjykatat veprojnë dhe vendosin për marrëdhëniet personale, familjare, pronësore dhe gjendjet dhe marrëdhëniet e tjera juridike të përcaktuara me Ligjin për Procedurë Jashtëkontestimore ose me tjetër ligj (**në tekstin e mëtutjeshëm: procedura jashtëkontestimore**).

4. Çfarë kuptimi kanë shprehjet vijuese?

“**Seancë**” është pjesë e procedurës gjyqësore, respektivisht Termini që e ka caktuar gjykata për nxjerrjen e provave ose për ndërmarrjen e veprimeve të tjera procesuale në lëndë.

“**Palë**” në procedurën kontestimore janë paditësi dhe i padituri.

“**Personi i tretë**” në procedurën kontestimore janë: ndërhyrësi, paraardhësi i emëruar dhe personi i tretë i njoftuar për kontestin.

“**I autorizuari i palës**” mund të jetë 1) avokat, 2) person jurist i diplomuar i cili me palën është në marrëdhënie pune dhe 3) i afërm i gjakut në vijë të drejtë, vëlla, motër ose bashkëshort, nëse është plotësisht i aftë ligjërisht.

“**Publik në procedurë kontestimore**” domethënë secili person pa asnjë lloj interesi, mund të marrë pjesë në shqyrtimin kryesor.

“**Pjesëmarrës**” në procedurë jashtëkontestimore janë: propozuesi dhe kundërshtari i propozuesit.

“**Qendra për Punë Sociale**” merr pjesë kur në procedurë vendoset për të drejtat dhe interesat e të miturit dhe të personave të tjerë të cilët janë nën mbrojtjen e posaçme të shtetit.

“**Përrjashtimi i publikut**” në procedurë për rregullimin e marrëdhënive dhe gjendjeve personale dhe familjare.

“**Dëshmitar**” në procedurë është personi i cili i paraqet njohuritë e tij dhe atë që ka vërejtur për gjërat që kanë ndodhur para se të jep deklaratën e tij.

“**Ekspert**” në procedurë është personi i cili posedon liçencë për ekspertizë nga lëmia përkatëse dhe është i regjistruar në regjistrin e ekspertëve.

“**Përfaqësues i përkohshëm**” gjykata mund t'i caktojë secilës palë ose pjesëmarësi në procedurë kur për këtë ekzistojnë kushtet e parashikuara me Ligjin për Procedurë Kontestimore.

“**Internet**” është rrjeti nga rrjetet të cilat janë të lidhura mes veti dhe të cilat e shfrytëzojnë Internet Protokolin (IP- Internet Protocol) për ndërlidhje dhe shkëmbim të informacioneve (pa dallim të tipit) mes rrjeteve të ndara dhe shfrytëzuesve të cilët janë të lidhura në to.

“**Platforma virtuale**” është sistem i cili mundëson kryerjen e disa aplikacioneve në të njëjtin mjedis, ndërsa shfrytëzuesve u mundëson qasje përmes internetit.

5. Si të vishem për gjykimin në distancë?

Edhe pse nuk duhet të vini personalisht në gjykatë, respektivisht në ndërtesën e gjykatës, megjithatë duhet të jeni të veshur në mënyrë adekuate për gjykimin në distancë. Gjatë gjykimit në distancë nuk guxon të paraqiteni të veshur me pantallona të shkurta dhe me sandale, të mos mbani kapelë në kokë dhe syze për diell, por edhe shpatullat nuk duhet të jenë të zbuluara pa marrë parasysh sezonin. Nëse gjykatësi vëren se nuk jeni të veshur në mënyrën e duhur, nuk do Ju lejojë të merrni pjesë në seancë.

6. Çfarë do të ndodhë në gjykimin në distancë?

Kur seancat gjyqësore mbahen personalisht në ndërtesën e gjykatës, ato jo gjithmonë fillojnë në kohë për shkak se gjykatësit shpesh herë u lejojnë personave të involvuar në procedurë njëfarë fleksibiliteti që të mund të bisedojnë për çështjet para se të vijnë në sallën e gjykimit. **Gjykimi në distancë gjithmonë duhet të fillojë në kohën e caktuar.** Me të vërtetë është e rëndësishme që të gjitha diskutimet që personat e involvuar në procedurë dëshirojnë t'i bëjnë me personat e tjerë të përfshirë në rastin, atë duhet ta

bëjnë para fillimit të seancës dhe se të gjithë duhet të jenë të përgaditur dhe të presin para kohës së caktuar për seancë.

Shpeshherë janë të nevojshme disa minuta që të gjithë të kyçen në seancë. Në fillim të seancës, gjykatësi do të shpjegojë se seanca regjistrohet, gjë që gjithashtu ndodh edhe gjatë seancave që mbahen në sallën e gjykatës.

Paraqet vepër penale dhe mosrespektim të gjykatës nëse pa leje regjistrohet gjatë seancës. Gjykatësi gjithashtu do të shpjegojë se seanca mbahet nga distanca dhe se kjo gjë nuk e ndryshon natyrën serioze ose rëndësinë e seancës.



Nëse seanca është jopublike, domethënë se publiku nuk mund të marrë pjesë (ky është rast për disa lloje të kontesteve familjare), gjykatësi mund të kontrollojë që të sigurohet se personi i involvuar në procedurë është vetë dhe në ambient të veçantë.

Lehtësisht mund të ndodhë që të flitet rastësisht për persona të tjerë gjatë gjykimit në distancë, e kjo nënkupton se personat mund të përhumben pak ose të dalin jashtë teme. Gjykatësi me siguri do të jetë mjaft i rreptë në sigurinë e të dhënave të njerëzve duke e kthyer fjalën dhe do t'ju lut që të mos ndërpritet mbarvajtja e seancës. Do të ishte ide e mirë që të rregullohet funksioni “mute” (fikja e mikrofonit në pajisjen e juaj), përveç se kur me të vërtetë flisni, ashtu që zhurma në sfond nuk i pengon njerëzit që të dëgjojnë se çka flitet. Do të ndihmonte nëse e shihni funksionin “mute” para fillimit të seancës, që të dini se si të kyçeni në funksionin “mute” dhe përsëri të ktheheni kur do të duhet të flisni.

Gjykatësi në pajisjen e tij do të ketë kopje digjitale të të gjitha akteve (kjo quhet “Paket” (“Bundle”)). Duhet të jeni të sigurtë se, nëse është e mundur, do ta keni në dispozicion paketin ose të gjitha dokumentet më të rëndësishme për ju, ashtu që nëse dikush thirret në ndonjë faqe ose dokument të caktuar do ta dini se për çfarë flet. Kjo do të jetë pak e papërshtatshme nëse keni vetëm një pajisje, kështu që para seancës, mendoni se si të menaxhoni më mirë me të.

Një ide e mirë është që gjatë rrjedhës së seancës të keni stilolaps dhe letër që të shënoni vërejtjet ose të keni dokument bosh të hapur në pajisjen e juaj për të shënuar vërejtjet.

Në disa video platforma është e mundur që personat e kyçur të ndajnë dokumentet në ekranet e tyre. Me këtë mundet që më lehtë të ndiqet se çfarë ndodh, dhe është e

dobishme nëse dikush e ka të vështirë për të gjetur faqen ose dokumentin për të cilin flet pala tjetër.

Gjykatësit mund të paraqesin prova me dëgjim të palëve dhe ekspertëve gjatë gjykimit në distancë dhe mund të sjellin urdhëra. Do të varet nga gjykatësi në rastin e juaj që të vendosë nëse është e drejtë dhe e përshtatshme që ndonjë seancë të mbahet nga distanca, dhe nëse nuk është, cilat janë alternativat e mundshme.

Duhet t'i thuhet gjykatësit për çfarë do lloj vështirësish me të cilat përballeni, për të cilat përndryshe nuk mund të dihet.

7. Si kyçem në gjykimin në distancë?

Para seancës do t'ju dërgohen udhëzime për kyçje, ose nga gjykata ose nga i autorizuari i cili e organizon lidhjen.

Nëse seanca mbahet nëpërmjet telefonit, atë zakonisht e organizon gjykata dhe ata do t'ju lajmërohen që të mund të merrni pjesë. Me rëndësi është që të jeni të sigurtë se gjykata e ka numrin e telefonit tuaj të **azhurnuar** dhe se jeni të gatshëm të përgjigjeni në thirrjen kur të vjen. Gjykata mund të lajmërohet nga numër i rezervuar (thirrësi mund të paraqitet, për shembull, si thirrës i panjohur). Nëse telefoni i juaj është i vendosur në “Mbah refuzimin”, sigurohu nëse është i fikur që të mos e humbni telefonatën.



Gjykata mund të lajmërohet nga numër i rezervuar (thirrësi mund të paraqitet, për shembull, si thirrës i panjohur). Nëse telefoni i juaj është i vendosur në “Mbah refuzimin”, sigurohu nëse është i fikur që të mos e humbni telefonatën.

Sigurohu nëse telefoni ose pajisja juaj është i karikuar ose është i lidhur në rymë elektrike që të mos punojë nëse nuk ka bateri gjatë zgjatjes së seancës, sepse video thirrjet mund ta harxhojnë shpejt baterinë. Nëse gjykata nuk mund të lidhet sërish me ju gjatë seancës, seanca mund të vazhdojë pa prezencën tuaj.



Nëse seanca mbahet nëpërmjet video lidhjes, kjo mund të bëhet përmes njërës nga disa platforma të ndryshme. Cila platformë do të përdoret, do t'ju dërgohen udhëzime të cilat mund të ndiqen me lehtësi.

8. A ka shpenzime kyçja në gjykimin në distancë?

Zakonisht nuk do t'ju kushtojë që të kyçeni në gjykimin në distancë. Do t'ju duhet që të keni lidhje të mirë telefonike për gjykim me telefon dhe ËiFi internet-lidhje të mirë për video gjykim. Nëse jetoni diku me sinjal të dobët telefonik, por keni ËiFi, kontrolloni nëse mund të transferoni telefonin e juaj në "ËiFi thirrje" që të mund të lidheni me telefon përmes ËiFi suaj. Nëse mbështeteni në rrjetin 3G ose 4G që të merrni pjesë në video gjykim, mundet që shumë shpejt t'i harxhojë të dhënat tuaja, gjë që mund të kushtojë dhe jo gjithmonë siguron lidhje mjaft të mirë. Më së miri është që të jeni diku me ËiFi, nëse është e mundur. Nëse gjykimi i juaj është gjykim telefonik, gjykata do t'ju lajmërohet, që domethënë se nuk do ta harxhoni kreditin e juaj telefonik.

9. Cilat pajisje, aplikacione ose softver më duhen?

Kërkesa themelore është një telefon funksional me lidhje të sigurtë. Madje, edhe nëse gjykimi i juaj është video gjykim, akoma mund të kyçeni përmes telefonit, por do ta keni shumë më të lehtë të ndiqni nëse keni mundësi të lidheni përmes video lidhjes. Do te ishte ideale nëse keni një ose më shumë pajisje që mund të lidhen në internet, që të mund të kyçeni në seancë përmes video/internet-lidhje në njërin, dhe mund t'i shikoni dokumentet e juaja në pajisjen tjetër, por shumë persona mund ta bëjnë vetëm me një pajisje.

Nëse keni vetëm një pajisje ose keni vështirësi në qasjen në dokumente, mund të pyesni nëse dokumentat mund të shpërndahen nga dikush tjetër në ekranin ku diskutohet. Kjo do të jetë e mundur ose nuk do të jetë e mundur, në varësi të platformës në të cilën organizohet seanca.

Ekzistojnë numër i madh i video platformave të ndryshme që mund të përdoren që të realizohet gjykimi në distancë (për shembull, Microsoft Teams, ZOOM, BlueJeans, Cisco Ëebex, GOOGLE Meet, JITSI Meet, CourtCall dhe të tjera), por shumica e tyre punojnë në mënyrë shumë të ngjajshme. Ju mund të jeni mësuar të bëni video thirrje në Facetime, Skype ose ËhatsApp. Platformat të cilat shfrytëzohen për gjykim janë shumë të ngjajshme me ato, por kanë mundësi që të bashkohen më shumë persona në të njëjtën kohë.



Me disa video platforma, ndoshta do t'ju ftojnë që të shkarkoni aplikacionin, por nëse preferoni, shumica e platformave ju mundësojnë që të bashkoheni përmes internet shfletuesit tuaj.

Shumë platforma punojnë më së miri me internet shfletuesin Google Chrome. Nëse nuk e keni, lehtësisht mund të shkarkoni Google Chrome shfletuesin, për çdo rast.

10. Çfarë nëse jam i shqetësuar se nuk mund ta punoj teknologjinë?

Para fillimit të gjyqimit do t'ju dërgohen udhëzimet. Nëse jeni të shqetësuar se nëse mund të lidheni në video gjykim në ditën e caktuar, mund ta provoni me testim. Mund të kërkonte nga i autorizuari juaj që të vendosë linkun, nëse nuk keni të autorizuar, mund ta pyesni të autorizuarin i cili e ka vënë linkun.

Edhe pse shumë persona nuk kanë njohuri për teknologjinë, e njëjta funksionon shumë lehtë sepse nëse njëherë i'u bie lidhja, gjykatësi dhe të autorizuarit mund t'ju ndihmojnë në shmangien e çfarë do lloj problemit.

11. A mund të kem dikë pranë gjatë kohës së gjyqimit në distancë?

Nëse gjykimi i juaj është publik (shumica e rasteve civile) nuk ka kufizime se kush mund të jetë i pranishëm. Megjithatë, disa konteste private dhe familjare nuk janë publike. Ata kryesisht janë jopublike.

Nëse gjykimi juaj është jopublik atëherë duhet të jeni vetëm, përpos nëse gjykatësi ju jep leje që dikush të jetë me ju.

Shoqërues i viktimës së dhunës familjare mund të jetë çdo person madhor i cili mund të jep ndihmë dhe përkrahje gjatë zgjidhjes së problemit me dhunë familjare.

Shoqëruesi i juaj mund të jetë në lokacionin e njëjtë si ju gjatë dëgjimit ose mund t'i bashkangjitet dëgjimit nga ndonjë vend tjetër. Nëse seanca është jopublike, gjykatësi mund t'i kërkojë shoqëruesit që të pohojë se e ka kuptuar se duhet t'i mban gjërat në konfidencë, dhe atë para fillimit të seancës. Secili që mer pjesë në seancë që t'ju ndihmojë dhe t'ju përkrahë, duhet të heshtë gjatë gjithë kohës.

Nëse në seancë merr pjesë një ose më shumë fëmijë, atëherë, nëse është e mundur, fëmija, respektivisht të gjithë fëmijët duhet të mbledhen në mënyrë të sigurtë, jashtë rrezes së zërit dhe të mbikëqyren në një ambient tjetër gjatë kohës së dëgjimit. Kjo është me rëndësi të veçantë nëse bëhet fjalë për çështje familjare për ata.

Nëse dëshironi të keni shoqërues në gjykimin tuaj në distancë, duhet të lejoni që gjykata paraprakisht të ketë njohuri për këtë.

Gjykatësit duhet t'i thoni:

- numrin e lëndës tuaj,
- kush është shoqëruesi juaj,
- çfarë është roli i saj/tij ose marrëdhënia e tyre me ju,
- si mund të kontaktohen (e-posta dhe/ose telefoni).


Kjo do t'i mundësojë gjykatësit që të bëjë aranzhmane që të keni shoqërues në seancë, madje edhe nëse është/janë në lokacion të ndryshëm nga ju, ndërsa gjykatësi mund të vendosë a do t'i/t'ju lejohet.

Edhe më tej mund ta pyesni gjykatësin për shoqëruesin në fillim të seancës, ndërsa nëse nuk keni pasur mundësi ta bëni këtë paraprakisht, është më mirë ta bëni më parë.

12. Çfarë nëse duhet të bisedoj privatisht me përfaqësuesin tim ose shoqëruesin gjatë gjyimit?

Nëse keni përfaqësues ose shoqërues, mund të flisni me ata me mënyrën më të mirë të komunikimit gjatë gjyimit në distancë. Normalisht, mund t'i pëshpërisni përfaqësuesit tuaj në sallën e gjykatës, por gjatë gjyimit në distancë mund të përdorni ËhatsApp, ose e-postën, ose video lidhje të veçantë ose thirrje telefonike për komunikim privat, varësisht nga nevoja dhe rrethanat e juaja të veçanta.

When two people converse privately, they are always in a conversation that is private – two private conversations and one public conversation.



Në disa platforma, mundet të vendoset “dhomë” private ku personi i involvuar në procedurë mund të ketë diskutim privat me përfaqësuesin ose shoqëruesin (ndonjëherë e emëruar si “Dhoma e arratisjes”). Gjykatësi ose personi i cili e organizon seancën mund të ketë mundësi që të vendosë këtë funksion për ju.

13. Çfarë nëse dëshiroj ballë për ballë – gjykim “normal”?

Nëse mendoni se rasti i juaj duhet të mbahet ballë për ballë për çfarë do arsye, duhet të njoftoni Gjykatën.

Gjykatësi duhet të sjellë vendim nga rasti në rast varësisht nga:

- natyra e rastit dhe seanca specifike,
- nevojat e veçanta të personave të involvuar, dhe
- çfarë është e sigurtë dhe praktike.



Nëse keni paafësi që e bën gjykimin në distancë jopraktik ose joadekuat, ose nëse duhet të bëhet ndonjë përshtatje që të mund të merrni pjesë, duhet që të kontaktoni Gjykatën, duke shpjeguar për vështirësinë dhe atë që mendoni se mund të ndihmojë që punët të jenë më mirë për ju.

14. Çfarë nëse diçka shkon keq?

Me rëndësi është që të kuptoni se çfarë ndodh gjatë gjyimit, dhe nëse bëni përpjekje më të mëdha që ta shikoni, dëgjoni ose ta ndiqni, duhet që në kohë ta njoftoni gjykatësin. Këtë mund ta bëni me të folur, ngritje të dorës ose (në disa platforma) me shtypjen e butonit që të çohet dora “Virtuale”.



Mbani mend se, në disa platforma, gjykatësi ndoshta nuk mund të shikojë fytyrën e të gjithëve në të njëjtën kohë, prandaj nëse dora juaj nuk e tërheq vëmendjen e tyre, ndoshta do të duhet ta ndërprisni. Nëse ka zhurmë në sfond, gjykatësi mund të kërkojë nga të gjithë që flasin që t'i heshtin mikrofonët e tyre.

Ndonjëherë njerëzit janë të përjashtuar nga mundësia që të dëgjojnë. Zakonisht, njerëzit që janë prapa do t'i lajmërojnë ata se ju jeni larguar, prandaj ata ose do të tentojnë që të kyçen përsëri ose do të presin që ju të thirrni përsëri. Mirë është që të mbani udhëzimet për kyçje gjatë seancës që të dini se ku t'i gjeni nëse ndodh çkyçja.

Nëse internet-lidhja e juaj ndërpritet, ndoshta është e rëndësishme që të bashkangjiteni me telefon, dhe nëse mundet të paralajmëroni dikë në lidhje me problemin që të mund t'ia transmetojë gjykatësit, atëherë provo dhe rregulloje. Nuk duhet të brengoseni se do të jeni në telashe për shkak të problemeve me lidhjen.

15. Çfarë ndodh pas gjykimit në distancë?

Gjykata do të përgadit procesverbal për seancën dhe nga një kopje do t'ju dërgojë palëve respektivisht pjesëmarrësve. Nëse të njëjtët kanë përfaqësues, një kopje e proceverbalit do t'ju dërgohet edhe atyre. Nëse procesverbali nuk do të mund të arrijë te ju, atëherë është mirë që të shkruani një shënim për atë se çfarë ka kërkuar gjykata nga ju, për datën deri kur duhet të bëhen disa punë të caktuara ose për datën se kur do të mbahet seanca e ardhshme. Kjo veçanërisht nëse nuk keni përfaqësues që t'ju kujtojë.

16. Ku mund ta gjej doracakun?

Doracakun për gjykim në distancë në Procedurë Civile mund ta lexoni në veb faqen e Gjykatës Themelore Dibër:

www.osdebar.mk